



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu  
Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 1/110

Datë: 20 / 5 / 2025

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenet 20 dhe 151 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2025, miratoi këtë:

### **RREGULLORE PËR TRANSFERIM, PROGRAMIN 'BRAIN GAIN' DHE RASTET E NEVOJËS SË JASHTËZAKONSHME TË REKRUTIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave për zbatimin e nenit 151 të Statutit të Universitetit të Prishtinës në lidhje me transferimin, programin "Brain gain" dhe rastet e nevojës së jashtëzakonshme për rekrutim të personelit akademik në universitet.
2. Qëllimi i dispozitave të përcaktuara me këtë rregullore për rekrutim të personelit akademik është rritja e qasjes në kuadër të talentuar dhe ndërkombëtarisht konkurrues, që është i punësuar apo që ka kryer së paku një apo më tepër nivele studimi jashtë vendit, në një universitet që është në mesin e katërqind (400) universiteteve më të mira në botë sipas renditjes së bërë nga "Times Higher Education" ose "QS World University Rankings".

3. Kjo rregullore promovon arritjen e standardeve të larta akademike e shkencore, sidomos atyre që ndërlidhen me punën kërkimore dhe nivelin e studimeve nëpërmjet rekrutimit të stafit akademik nga universitetet prestigjioze botërore.

## **Neni 2**

### **Transferimi i personelit akademik nga universitetet tjera**

1. Personeli akademik që është në marrëdhënie të rregullt pune<sup>1</sup> në një universitet që është në mesin e katërqind (400) universiteteve më të mira në botë sipas renditjes së bërë nga “Times Higher Education” ose “QS World University Rankings”, ka të drejtë transferimi në Universitetin e Prishtinës pa iu nënshtruar procedurave të konkursit publik. Kërkesa për transferim bëhet me propozimin e arsyetuar të rektorit, dekanit ose këshillit të njësisë akademike përkatëse dhe miratohet nga senati.
2. Marrëdhënia e rregullt e punës nënkupton së paku 2 vite të plota akademike përvojë në mësimdhënie dhe/apo punë kërkimore në universitetin përkatës. Kjo duhet të dëshmohet nëpërmjet kontratës valide që kandidati ka me universitetin prej të cilit transferohet.
3. Personeli akademik, që përmbush kushtet e këtij neni, ka të drejtë të transferohet në Universitetin e Prishtinës edhe me marrëdhënie jo të rregullt pune (“part-time”). Kjo marrëdhënie përcaktohet me kontratën e punës që personeli akademik nënshkruan me Universitetin e Prishtinës. Me qëllim të stimulimit të transferimit të personelit akademik nga universitetet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, rektori, dekani apo këshilli i njësisë akademike, me një arsyetim të veçantë, mund të propozojnë emërimin në thirrje akademike më të lartë nga ajo që kandidati mban në universitetin përkatës. Në këto raste të veçanta, personeli akademik duhet të kalojë në marrëdhënie me orar të plotë në Universitetin e Prishtinës dhe në momentin e marrjes së titullit më të lartë, duhet të tejkalojë kriteret formale të avancimit, të parapara në Statutin e UP-së dhe të sqaruara në Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, avancimin dhe rizgjedhjen e personelit akademik.
4. Në rastet kur propozohet emërimi në thirrjen më të lartë sipas paragrafit 4 të këtij neni, procesi përzgjedhës i nënshtrohet vlerësimit të një komisioni ndërkombëtar me profesorë të rregullt nga katërqind (400) universitetet më të mira në botë sipas renditjes së bërë nga “Times Higher Education” ose “QS World University Ranking”. Këtë komision e themelon Senati i UP-së.
5. Personeli akademik që transferohet në Universitetin e Prishtinës është i obliguar të vendosë afiliimin e Universitetit të Prishtinës në të gjitha publikimet dhe komunikimet përkatëse, nga momenti i themelimit të marrëdhënies së punës me Universitetin e Prishtinës.

---

<sup>1</sup> Marrëdhënie e rregullt nënkupton marrëdhënie me normë të plotë ose jo të plotë dhe mbajtje e një titulli akademik universitar.

### Neni 3

#### **Rekrutimi i personelit në kuadër të programit të „kthimit të trurit” (“brain gain”)**

1. Të drejtë për të përfituar nga programi i „kthimit të trurit” (“brain gain”) kanë personat që kanë mbaruar së paku një nivel të studimeve në njërin nga universitetet që është në mesin e katërqind (400) universiteteve më të mira në botë sipas renditjes së bërë nga “Times Higher Education” ose “QS World University Rankings”, duke marrë në konsideratë edhe fushën përkatëse në vitin e diplomimit. Në rastet kur ka më shumë se një kandidat që i plotëson kushtet për emërim, përparësi ka kandidati që ka përfunduar studimet e doktoratës në 400 universitetet më të mira, në raport me kandidatin që ka përfunduar nivelin e studimeve master në këto universitete. Në rastet e studimeve të kryera në vend apo në rajon, ato duhet të jenë të kryera në institucione të nivelit universitar.
2. Personeli akademik që rekrutohet përmes konkursit publik në kuadër të zbatimit të programit për kthimin e trurit “brain gain”, duhet t’i plotësojë kriteret formale për emërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës, të përcaktuara me statut dhe rregullore përkatëse, përkatësisht për titullin e profesorit asistent, të ketë doktoratën në njërin prej katërqind (400) universiteteve më të mira në botë sipas renditjes së bërë nga “Times Higher Education” ose “QS World University Rankings”.
3. Personeli akademik që rekrutohet përmes konkursit që zbaton një program për „kthimin e trurit” në Universitetin e Prishtinës, është i obliguar të vendosë afiliimin e Universitetit të Prishtinës në të gjitha publikimet dhe komunikimet përkatëse, nga momenti i themelimit të marrëdhënies së punës me Universitetin e Prishtinës.

### Neni 4

#### **Rastet e nevojës së jashtëzakonshme**

1. Në raste të nevojës së jashtëzakonshme, rektori, pasi të ketë marrë lejen e Senatit dhe të Këshillit drejtues (për pjesën e buxhetit), mund të shpallë një konkurs për personel akademik me kontratë fikse jo më të gjatë se dy (2) vjet, pasi të ketë konsultuar dekanin e njësisë përkatëse akademike.
2. Nevojë e jashtëzakonshme konsiderohet situata kur një njësi akademike apo një program i saj i rëndësishëm rrezikon shuarjen për shkak të mungesës së personelit përgjegjës akademik apo krijimit të një programi të ri sipas nevojave të tregut dhe me interes të veçantë për universitetin dhe njësinë akademike.
3. Personeli akademik që rekrutohet në raste të nevojës së jashtëzakonshme sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, duhet t’i plotësojë kriteret formale për emërimin dhe avancimin e personelit akademik të Universitetit të Prishtinës, të përcaktuara me statut dhe rregullore përkatëse.

4. Zgjedhja e personelit akademik në këto raste i nënshtrohet vetëm procedurës së emërimit në Senat.
5. Personeli akademik që rekrutohet bazuar në rastet e nevojës së jashtëzakonshme në Universitetin e Prishtinës është i obliguar të vendosë afilimin e Universitetit të Prishtinës në të gjitha publikimet dhe komunikimet përkatëse, nga momenti i themelimit të marrëdhënies së punës me Universitetin e Prishtinës.

## **Neni 5**

### **Procedura e transferimit në UP të personelit akademik që është në marrëdhënie të rregullt të punës në top 400 universitetet më të mira**

1. Shprehja e interesimit për transferim në UP, sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje, mund të bëhet nga vetë personeli/kandidati, duke kontaktuar një nga organet përgjegjëse të universitetit apo nësisë akademike. Kërkesa për transferim bëhet me propozimin e arsyetuar të rektorit, dekanit ose këshillit të nësisë akademike.
2. Senatit duhet t'i prezantohet evidenca mbi përmbushjen e kriterëve të parapara me nenin 2 të kësaj rregulloreje nga ana e kandidatit që transferohet, përmes një raporti të arsyetuar nga rektori, dekani ose këshilli i nësisë akademike. Dekani i nësisë akademike apo rektori këtë evidencë e prezanton para Senatit, jo më larg se 30 ditë pas inicimit të procedurës sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Në rast se përzgjedhja në titullin akademik ekzistues e personelit akademik që transferohet në Universitetin e Prishtinës i është nënshtuar vlerësimit nga ana e një komisioni vlerësues nga universiteti prej të cilit ai/ajo vjen, personi transferohet drejtpërsëdrejti në titullin e njëjtë akademik, të cilin e mban në universitetin prej nga vjen (duke ndjekur procedurat e mësipërme). Kandidati/ja prezanton dëshminë e vlerësimit përkatës nga ana e universitetit prej nga vjen. Këtë dëshmi dekani ose rektori e prezanton si pjesë të evidencës para Senatit, sipas paragrafit 2 të këtij neni.
4. Në rast që transferimi i personelit akademik rezulton në përzgjedhje në titull më të lartë akademik në Universitetin e Prishtinës, atëherë personeli akademik i nënshtrohet procesit të specifikuar në nenin 2 paragrafi 3 të kësaj rregulloreje.
5. Inicimi i procedurës për transferimin e personelit, siç parashihet në nenin 2, mund të bëhet pavarësisht kërkesave rreth fondit të orëve apo normës që parashihet me procedurat e zakonshme të emërimit të personelit akademik në universitet.
6. Përgjegjësitë e punës, përkatësisht angazhimit të personelit të transferuar, përcaktohen dhe arsyetohen në një nen të veçantë të kontratës, që i ofrohet personelit të transferuar.

## Neni 6

### **Propozimi i konkursit, komisionet dhe procedura e vlerësimit të personelit akademik në kuadër të programit për „kthimin e trurit” (“brain gain”)**

1. Konkursi për rekrutimin e personelit akademik përmes programit të „kthimit të trurit” (“brain gain”), siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj rregulloreje, shpallet bazuar në propozimin e arsyetuar të rektorit, dekanit ose këshillit të njësisë akademike.
2. Arsyetimi i propozimit duhet të bazohet në nevojat e UP-së, përkatësisht njësisë akademike dhe ekzistimin e fondit të orëve (normës) që parashihet për emërimin e personelit akademik në universitet, në lidhje me pozitat e reja që shpallen me konkurs publik.
3. Në mbledhjen e Senatit, në të cilën aprovohet propozimi për shpalljen e konkursit publik, formohen Komisioni vlerësues dhe Komisioni i veçantë i ankesave. Sipas nevojës, formimi i Komisionit vlerësues mund të shtyhet për një afat prej 30 ditëve pas shpalljes së konkursit.
4. Në konkursin e shpallur, përcaktohen kushtet specifike për rekrutimin e kësaj kategorie të personelit.
5. Procesi përzgjedhës i nënshtrohet vlerësimit të një komisioni ndërkombëtar me profesorë në marrëdhënie të rregullt të punës në një nga katërqind (400) universitetet më të mira në botë sipas renditjes së bërë nga “Times Higher Education” ose “QS World University Ranking”. Propozimi i rektorit, dekanit ose njësisë akademike duhet të jetë i arsyetuar edhe sa i përket superioritetit akademik të anëtarëve të komisionit. Komisioni, në përbërje prej 3 ose 5 anëtarëve, emërohet me vendim të Senatit të UP-së.
6. Komisioni duhet të vlerësojë dhe analizojë me kujdes programin e studimit jashtë vendit për secilin kandidat që propozon, duke arsyetuar se programi (Bachelor, Master apo Doktoratë), përmbajtja e tij, lëndët e përfshira ose specializimet dhe studimet tjera që ka kryer kandidati/ja e bëjnë të përshtatshëm/e për t’u zgjedhur në pozitën, në të cilën ka aplikuar. Në dhënien e mendimit për zgjedhjen dhe vlerësimin e fushës së studimit, komisioni mund të marrë për bazë edhe programin dhe përgatitjen e kandidatit për pjesën e studimeve të kryera në Universitetin e Prishtinës, nëse kandidati/ja një ose disa nivele të studimit i ka përfunduar në UP.
7. Kandidatët, përveç tjerash, duhet të dorëzojnë edhe një arsyetim të profilit të programit të studimit, përshkrim të lëndëve, fushës së specializimit të tyre, si dhe të dhëna të tjera që mund të jenë relevante për pozitën në të cilën aplikojnë.
8. Komisioni mund të realizojë intervistë me kandidatët që aplikojnë për pozitat e reja të shpallura nga UP-ja. Intervista mund të realizohet me prezencë fizike ose online. Për mbajtjen ose jo të intervistës vendos Komisioni vlerësues me shumicë të votave.
9. Komisioni vlerësues, brenda një afati prej 30 ditëve nga emërimi, e dorëzon raportin vlerësues me shkrim për kandidatët në Zyrën për Çështje Akademike dhe Rektoratin



- e UP-së, për publikim. Me vendim të rektorit, ky afat mund të zgjasë më së shumti edhe 30 ditë të tjera.
10. Pas afatit prej 15 ditëve nga shpallja/publikimi i raportit, kandidatët e pakënaqur mund të paraqesin ankesë në afat prej 7 ditëve në Komisionin e veçantë të ankesave.
  11. Komisioni i veçantë i ankesave përbëhet nga tre (3) anëtarë. Anëtarët e Komisionit të ankesave janë përfaqësues nga personeli akademik i fakultetit përkatës ose profesorë ndërkombëtarë. Komisioni i ankesave emërohet nga Senati në bazë të propozimit të arsyetuar të rektorit, dekanit ose këshillit të njësisë akademike, që ka propozuar shpalljen e konkursit, sipas paragrafit 1 të këtij neni.
  12. Anëtarë të komisionit të veçantë të ankesave nuk mund të jenë: rektori, prorektorët, dekani dhe prodekanët.
  13. Komisioni i veçantë i ankesave ka për detyrë të shqyrtojë ankesat pas kalimit të afatit të publikimit të raportit vlerësues. Komisioni i paraqet raport me shkrim Senatit të UP-së në një afat prej 15 ditëve nga përfundimi i afatit për ankesa ndaj raportit të komisionit vlerësues. Komisioni i ankesave në raportin e tij, mund t'i rekomandojë Komisionit vlerësues që të plotësojë, të rishqyrtojë ose arsyetojë aspekte të caktuara të raportit vlerësues dhe propozimeve të dhëna.
  14. Pas vendimit të Senatit për zgjedhjen apo moszgjedhjen e kandidatëve për pozitat e shpallura me konkurs publik, për shqyrtimin e ankesave ndaj këtij vendimi është kompetent Komisioni i ankesave dhe parashtrësve i Senatit.

## **Neni 7**


### **Konflikti i interesit dhe shmangia e nepotizmit**

Nuk mund të rekrutohet personeli akademik nëpërmjet mekanizmave të paraparë në këtë rregullore nëse bie në kundërshtim me pikën 3 të nenit 153 të Statutit të Universitetit të Prishtinës.

## **Neni 8**

### **Dispozitat përfundimtare**

1. Për aspektet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, vlejné dispozitat në fuqi të Rregullores për emërimin, avancimin dhe rizgjedhjen e stafit akademik në Universitetin e Prishtinës.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit.



Prof. Arben Hajrullahu,

Rektor dhe Presues i Senatit të UP-së.